

ÇELËSAT
DREJT PAVARËSIMIT

(7)

Çelësat drejt pavarësisë

Si të arrijmë atë?

Dhoma 308, 8:30 pasdite: Jane shuan televizorin duke mos qënë në gjëndje të koncentrohet në programin të cilin ajo ishte duke shikuar. Vendos larguesin në tavolinën e natës pranë shtratit të saj në spital, zgjat (tërheq) qafën dhe vendos kokën në jastëk për të pushuar.

Gjithë ato mendime kalonin nëpër kokën e saj, që kur nga vizita e fundit e mjekut të saj ajo mësoi se së shpejti do të lëshohet nga qendra e rehabilitimit.

Zemra e saj rreh më shpejtë për shkak se ajo do të duhet të largohet që andej dhe të kthehet në shtëpi, në botën reale!

Ajo kujton të gjitha ngjarjet që kanë ndodhur vitin e kaluar, ngjarje të cilat ia lëkundën (shembën) botën e saj. Aksidenti, hospitalizimi, rehabilitimi, shpresat dhe dëshpërimet, gëzimet, dhimbjet, fitoret e vogla dhe dëshpërimet e mëdha.

Ajo tani e di se nuk do të ecë kurrë më dhe se në duart e saja do të ketë vetëm lëvizje të kufizuara edhe përkundrejt disa përmirësimeve në to. Në moshën 22 vjeçare, ajo duhet të paramendojë të kalojë jetën e saj në trup të paralizuar. “Kuatriplegja” është “ireverzibile (e pakthyeshme)”- tha mjeku. Ajo pjesën tjetër të jetës së saj duhet të lëvizë me karrocë.

Natyrisht, mjeku i tregoi se ajo mund të vazhdonte rehabilitimin e saj në një klinikë për pacientë të jashtëm në periudhë kohore të pakufizuar. Ajo gjithashtu duhet të mësojë të përdorë mjete ndihmëse dhe ndihmesa të tjera për jetë të pavarur në përditshmerinë e saj, të kompensojë kufizimet e saja dhe të zhvillojë dhe arrijë shkallën maksimale të mundshme të pavarësisë për të aftësuar atë të marrë pjesë në shoqëri.

Duke menduar për këtë, Jane bind veten që edhe përkundrejt fatit të saj të keq ajo ende është me fat, meqenëse ajo në fillim do të kthehet të jetojë me prindërit e saj. Prindërit e saj që tani kanë filluar me ndryshimet në shtëpinë e tyre, ndërtuan rampë për qasje, rregulluan dhomën e saj në përdhese, zgjeruan derën e banjos në mënyrë që ajo të mund të kalojë, etj... Mirë, çka mund të themi? Ajo do të shohë. Ka shumë gjëra për të cilat duhet menduar në të njëjtën kohë! Për të është e vështirë të dijë se nga të fillojë dhe kjo gjë e shqetëson mjaft.

Jane mund të kujtojë bisedën e saj me terapeutin okupues gjatë trajtimit të saj. Ajo ka mësuar se ekzistojnë mënyra të përshtatjes së shtëpisë ose banesës, për t'i bërë ato më të përshtatshme. Ekziston një gamë e gjërë e ndihmesave teknike të cilat mund të përdoren në shtëpi me qëllim të tejkalimit të kufizimeve vetjake dhe të aftësisë për të kryer disa nga aktivitetet e jetës së përditshme. Infermierja e siguroi Janen, se ajo do ti japë asaj një listë me të gjitha pajisjet e nevojshme mjekësore që janë të nevojshme për të si dhe vendet ku mund ti sigurojë (gjejë) ato. Punëtori social e informoi atë për ndihmën fizike dhe shërbimet për kujdes shtëpiak të cilat janë të nevojshme për personat me paaftësi.

Asaj gjithashtu I kujtohet se ka dëgjuar diçka për automjetet e adaptuara (përshtatura) për personat në karrocë.

Duke disponuar me një informacion kaq të bollshëm, ajo vendosi të marrë masa drastike: ajo vendos gështallën ortotike për shkrim (ndihmesë e cila vendoset në dorë duke mundësuar në këtë mënyrë mbajtjen e gjërave të ndryshme), ngjet lapsin në të dhe fillon të shkruajë të gjitha pyetjet të cilat I bien ndër mend mbi të gjitha ato që ajo duhet të dijë për mjetet ndihmëse në dispozicion të cilat mundësojnë jetë të pavarur.

Përfundimisht, pas diku një ore, e lodhur, ajo mbyll sytë e saj dhe dalë ngadalë bie në gjumë të thellë. Fillon të ëndërojë. Jane papritmas gjen veten në një bibliotekë të pafund, raftet e së cilës janë të mbushur me libra me tema të cilat e interesojnë atë. Ajo ndjehet paksa e dëshpëruar: “Si të gjej atë çka dëshiroj?” Eventualisht, duart e saja prekin një libër i cili duket shpresëdhënës: “Mjetet ndihmëse dhe ndihmesat e tjera për jetë të pavarur për persona me paaftësi: dhjetë pjesët e përfshira.” Libri u hap vetiu, dhe në faqen e parë ajo lexoi: “përmirësimet e bëra në pajisjet ekzistuese gjatë dy dekadave të fundit I kanë bërë ato më të përshtatshme dhe më funksionuese. Ky fakt, I kombinuar me emergjencën e teknologjisë së re që ka për qëllim kompensimin e kufizimeve funksionale të njerëzve me dëmtim të palcës kurrizore, mundëson një shkallë më të lartë të pavarësisë dhe gjithashtu rrit shpresën për t’iu kthyer jetesës aktive. Është e rëndësishme të përcaktohet se ndihmat teknike dhe ndihmesat e tjera të cekura në këtë broshurë kanë për qëllim të përmirësojnë pavarësinë funksionale të pesonave me paaftësi, dhe jo të zëvendësojnë funksionet reziduale (të mbetura) të këtyre njerëzve.”

Libri trajton 10 gjëra që lidhen me rehabilitimin:

1. ndihmesat për pavarësi personale
2. shtëpia
3. jeta e përditshme
4. mjedisi
5. kujdesi shtëpiak
6. transportimi
7. rrethi
8. asociacionet
9. komunikimi
10. ndihma financiare

të gjitha këto nuk janë të nevojshme për çdo person. Ju duhet të bëni një vlerësim real të nevojave tuaja personale dhe të zgjedhni pajisjet dhe mjetet më të nevojshme për kushtet e juaja jetësore.

Ndihmesat për pavarësi personale

Karroca është kryedisorja për pavarësi personale, meqenëse ajo mundëson lëvizshmërinë e pavarur. Çdo diskutim mbi karrocën domosdo duhet të përfshijë përdorimin e saj dhe

kualitetin e jastëkut. Për të mësuar më shumë për jastëkët e karrocës, ju lutem lexoni broshurën kujdesi për lëkurën tuaj.

Gjithashtu është e rëndësishme të përpilohet lista e pajisjeve të nevojshme medike dhe paramedike. Zakonisht, personeli i qendrës së rehabilitimit përpilon këtë listë dhe tregon se ku mund të sigurohen pajise të këtilla. Pajisjet e këtilla janë diskutuar në broshurën koordinimi i fshikëzës së paralizuar.

Karroca

Dy tipet themelore të karrocës janë: manuale (e zakonshme) dhe elektrike. Të dy tipet kanë variacione siç janë karroca shumë të lehta dhe që përfshijnë një seri të ndihmesave të cilat mund të bashkangjiten sipas nevojës.

Vlerësimi sistematik I tipit të karrocës e cila i nevojitet individit, bëhet nga grupi I profesionistëve në qendrën e rehabilitimit, si pjesë e programit të rehabilitimit.

Çdo person merr karrocë e cila i plotëson nevojat e tij/saj. Në Kanadë, zakonisht shpenzimet e blerjes, mirëmbajtjes dhe riparimit i paguajnë programet qeveritare mbi kujdesin shëndetësor.

Karroca, zakonisht vjen me instruksionet e përdorimit dhe mirëmbajtjes, si dhe listën e vendeve të cilat sigurojnë mirëmbajtjen dhe riparimin. Përdoruesit e karrocave elektrike (motorizuara), gjithmonë duhet të karrikojnë bateritë e tyre gjatë natës.

Shtëpia

Në fillim, planifikimi i kthimit në shtëpi mund të shkaktojë ankth (shqetësim). Sigurisht, ju mund të vendosni të shihni gjërat “në shkallë të lartë” dhe të keni shtëpi të re e cila është plotësisht e përshtatshme, e adaptuar sipas nevojave të përdoruesit të karrocës. Ju gjithashtu mund të bleni një banesë. Për këto gjëra ju mund të kërkonit shërbimet e ekspertëve për qasje (përshtatshmëri), por definitivisht, jo çdokush mund t’i ofrojë vetes zgjidhje të tilla për shkak të mjeteve financiare me të cilat ai disponon.

Për këtë shkak, më reale është të vlerësoni shtëpinë tuaj si dhe mjetet që keni në dispozicion për ta adaptuar atë.

Pronari i shtëpisë

Nëse ju jeni pronar i shtëpisë, mund të thërrisni shërbimet e organizatave ose ekspertët për përshtatje të shtëpive. Përmes punës me ekspertë të tillë, ju mund të shqyrtoni zgjedhjet më reale të mundshme duke pasur në konsideratë karakteristikat ekzistuese të shtëpisë.

Progresi në teknologjinë moderne tani bën të mundur instalimin e ashensorëve brenda ose jashtë shtëpisë. Ndihmesat dhe pengesat e kuzhinës mund të ndryshohen për të

mundësuar qarkulimin dhe zierjen (pregatitjen) nga karroca. Gjithashtu mund të zgjërohen kornizat dyerve kurse toaletet të përshtaten sipas nevojave.

Natyrisht, duhen të merren në konsideratë sasia e punës dhe shpenzimet rrjedhëse. Të dobishme mund të jenë disa programe qeveritare, por nëse jo, planet për sigurim privat ose publik mund të ndihmojnë në finansimin e plotë ose të pjesshëm të ndryshimeve në shtëpi,

Qiramarrësi

Nëse jeni qiramarrës, ajo çka ju duhet të bëni është, të merrni në konsideratë të gjithë ndërtesën në të cilën jetoni. Nëse jetoni në katin më të lartë të një ndërtese dy ose trekatëshe, do të ishte mirë të shqyrtonit zhvendosjen tuaj qoftë në katin përdhësë, ose në ndërtesë që ka ashensor dhe, nëse është mundur, komoditet për sa i përket parkimit. Shumica e ndërtesave, që nga hyrja deri te apartamenti juaj, janë të përshtatshme për karroca. Pas kësaj, është relativisht e lehtë të bëhen transformimet e nevojshme për brendinë e vendit të jetesës.

Të qenët qiramarrës ju bën të papërshtatshëm të pranoni ndihmë financiare e garantuar kjo për pronarët e shtëpive. Gjithashtu, leja me shkrim e pronarit është e domosdoshme para se të merrni përsipër çfarëdo pune përndryshe, ju mund të jeni përgjegjës në rast padie për dëmtimet dhe interes.

Në qendrat e mëdha urbanistike, ekzistojnë lista të njëjësive qiradhënëse të përshtatshme për karroca. Për të siguruar listat e këtilla, ju duhet të kontaktoni shoqatat e personave me paaftësi ose organizatat qeveritare përgjegjëse për përpilimin e listave të këtilla për strehim.

Procesi i integritit social fillon me modifikimin e vendit ku ju jetoni në mënyrë që sa më mirë të plotësoni nevojat tuaja. Kjo është esenciale në begatimin personal të individit.

Kur ky hap plotësohet, dhe kur për këtë bëni një gosti për familjarët dhe shoqërinë, mund të thuani , “është e mrekullueshme të jeshë në shtëpi!”

Lehtësimet e tjera rezidenciale

Për problemet e strehimit të cilat mund ti kenë disa njerëz, ekzistojnë edhe zgjidhje të tjera. Njerëzit me të ardhura të pakta mund të kërkojnë akomodim të përshtatshëm në “strehimin e lirë”. Ndërtesat e këtilla zakonisht janë pronë e qeverisë dhe janë të administruara nga organizatat komunale.

Burim tjetër i vlefshëm është subvencioni i qeverisë i cili mbulon një pjesë të qirasë. Edhe një herë, ky lloj burimi është për qiramarrësit me të ardhura të pakta gjendja fizike dhe financiare e të cilëve plotëson kriterin e kësaj të drejte. Ndërtesat, sidoqoftë, zakonisht u përkasin intereseve private. Pajtimi me kontratë, që me kohë duhet nënshkruar midis pronarit dhe organizatës qeveritare që bën pagesën.

Grupi kooperues gjithashtu mund të një burim interesant. Disa prej tyre kanë adoptuar konceptin për përshtatshmëri universale (të përgjithshme) për ndërtesat të cilat ato drejtojnë ose të cilat ato vetë I kanë ndërtuar ose rinovuar. Një pjesë e njësive me qira është I rezervuar për përdoruesit e karrocave.

Për ato të cilët nuk ndjehen të gatshëm ose nuk kanë burime të cilat janë të nevojshme të mundësojnë kthimin e menjëhershëm të tyre në shtëpi menjëherë pas largimit nga qendra e rehabilitimit, ekzistojnë edhe lehtësime të tjera residenciale. Disa institucione të tjera për kujdes shëndetësor, sigurojnë vazhdimsi të rehabilitimit, për aq kohë sa është e nevojshme për të plotësuar objektivat për riintegrim në shoqëri. Gjithashtu mjaft të dobishme mund të jenë edhe disa lehtësime të përkohshme të jetesës, siç janë psh, banimet e grupeve të vogla ose apartamentet e mbikqyrura, të cilat lejojnë individët të eksperimentojnë me jetesën si qirramarës ose në mjedis shoqëror të kontrolluar. Kjo faze I prinë riintegrimin të vërtetë social.

Është mirë që strehimi I integruar të diskutohet pak më thellë. Këto lloj strehimesh paraqesin komplekse ku shumë njerëz jetojnë në njësi të pvarura dhe ndajnë një koleksion të përbashkët të shërbimeve për kujdes shtëpiak.

Atëherë bëhet e mundur që për personin e ri me dëmtim të palcës kurrizore, ose çdo përdorues tjetër të karrocës, kthimin e tyre në komunitet ta shohin me optimizëm pak më të madh.

.....

Jeta e përditshme

Menjëherë pasi të ktheheni në shtëpinë e adaptuar, është koha për të menduar në organizimin e jetës së përditshme në shtëpi. Për përmbushjen e shumë detyrave (angazhimeve) shtëpiake ekzistojnë ndihmesa dhe pajisje të ndryshme. Jeni të kujdesshëm! Shpesh here, pajisjet e shumta vetëm do të çrregullojë hapësirën e të jetuarit. Do të ishte më mire ti jepnit vetes tuaj kohë të për të eksperimentuar dhe vlerësuar nevojat tuaja reale dhe të identifikoni se cilat ndihma dhe pajisje janë të përshtatshme për ju. Vlerësimi I terapeutit okupues do të përcaktojë se cilat ndihmesa teknologjike janë të nevojshme.

Mjetet e nevojshme për jetesë

- Pajisjet ndihmëse që përdoren për përgatitjen e shujtave siç është për shembull procesori I adaptuar për ushqim ose dora e zgjatur për arritjen e butonave kontrollues të shporetit elektrik.
- Pajisjet e kuzhinës, siç janë për shembull, pjatat e nxehta për zierje (gatum).
- Ndhimesat për vetë-ushqim, siç janë për shembull, pjatat e adaptuara me butona kundër –rëshqitjes dhe the ose piruni I adaptuar për njerëzit me aftësi të kufizuar të kapjes.
- Ndhimesat për larjen e enëve.

Aktivitetet shtëpiake

Pajisje ndihmëse për arritjen dhe mbajtjen e objekteve siç janë për shembull pjesjet që përdoren për të kapur dorezën e derës ose për të aritur ndërprerëset e dritës (rrymës).

Ndihmesat për transferimin e objekteve siç janë për shembull karroca e dorës.

Ndihmesat për pastrim, siç janë për shembull fshesa dhe fshirësja e pluhurit të adaptuara.

Mobilja e adaptuar: tavolinat për ushqim, tavolinat e natës.

Ndihmesat për kujdesin ndaj veshjes dhe rrobaqepsisë siç është për shembull hekuri dhe makina për qepje e adaptuar.

Higjiena, transferimi dhe aktivitetet e pozicionimit

-ndihmesat për higjienë personale siç janë për shembull ulëset e ngritura të toaletit, mbështetëse për duar, dush ose ulëse për të bërë banjë dhe tavolinë e banjos për transferim.

-ndihmesa për transferim dhe pozicionim siç janë për shembull krevatet e rehabilitimit dhe trapezet ose ashensorët e pacientëve.

Aktivitetet për kujdesin ndaj trupit

Është mjaft e rëndësishme të mbahet higjiena personale. Ekzistojnë ndihmesa për këtë gjë, siç është për shembull prerësi i adaptuar i thonjëve, gërshërët, dhe krëhëri.

Aktivitetet e të veshurit

Ndihmesat teknike bëjnë të mundur veshjen dhe çveshjen e pavarur, veshjen e çorapeve dhe këpucëve, mbërthyerjen e kopsave të këmishës ose bluzës, veshjen e pantallonave dhe shumë detyra të tjera.

Të veshurit gjithashtu mund të ndryshohet përmes përdorimit të mbylljes vetëngjithëse (Velcro) përmes së cilës mund të shpejtohet procesi i veshjes.

.....

Mjedisi (ambienti)

Kufizimet e funksioneve të personave mund të jenë mjaft të rëndësishme, duke penguar në këto raste, ndërveprimin efektiv me ndryshimet e menjëhershme të mjedisit. Rregullimi i ambientit, i cili i referohet automatizimit të shtëpisë, mund të rezultojë si e dobishme. Automatizimi në shtëpi, në kuptimin e ngushtë të fjalës, do të thotë se:” në shtëpi janë vënë në zbatim të gjitha teknikat drejtuese të automatizuara (komoditeti, siguria, komunikimi).”

Këto burime të teknologjisë së lartë duhet të kompenzojnë kufizime të caktuara të funksioneve motore dhe të mundësojnë një pavarësi më të madhe në kryerjen e aktiviteteve normale në shtëpinë tuaj dhe përreth.

Pajisjet e kontrollit të ambientit mundësojnë kontrollim të veçuar të shumë komponenteve, siç janë për shembull veglat (pajisjet), krevatet elektrike, ndriçimin, dyert, dritaret dhe perdet, të gjitha duke iu falenderuar shpikjeve me kontrollë nga larg.

Sistemet e këtilla mundësojnë (lejojnë) gjithashtu kontrollim automatik të nxemjes dhe të sistemeve për gjendjen e ajrit. Përfshirë brenda kësaj, prioritare është “blerja nga shtëpia”, pagesa e faturave nga shtëpia, dhe komunikime të tjera të jashtme si dhe aktivizimi i alarmit kur rrëzohet personi.

Shpikjet e këtilla për kontroll nga larg, aktivizohen qoftë përmes prekjes, njohjes së zërit ose frymëmarrjes. Gjithashtu mund të instalohen detektorët e lëvizjes.

Për shtëpitë që adaptohen, sistemet e automatizuara shtëpiake janë falas. Kjo nënkupton atë se funksioni I tyre është të përkrahin pavarësinë dhe jo të zëvendësojnë funksionet reziduale të personit.

.....

Kujdesi shtëpiak

Përkundrejt të gjitha adaptimeve të realizueshme, fizike dhe teknologjike, reintegrimi në shoqëri për një numër të madh të personave me dëmtim të palcës kurrizore nuk është i mundshëm pa përkrahjen nga shërbimet për kujdes shtëpiak.

Në Kanadë, programe të caktuara qeveritare të shërbimeve shëndetsore dhe sociale janë me mandat të veçantë për të ofruar shërbime mbështetëse të adaptuara për nevojat e personave me paafësi. Sidoqoftë, gjithashtu ekziston një rritje e numrit të agjensive private të cilët hapin dyert e tyre. Rekomandohet që ju të siguroni referenca para se të bëni marrëveshje me ndonjërin prej tyre. Shpeshherë, njerëzit të cilët sigurojnë shërbime të këtilla nuk kanë trajnim përkatës.

Shërbimet e këtilla kanë si qëllim të sigurojnë se personi mund të mbetet brenda komunitetit. Ato bazohen në mbështetjen e pavarësisë së personit, duke kompensuar kufizimet e tyre funksionale dhe duke bërë adresimin e nevojave të cilat rrjedhin si rezultat I këtyre kufizimeve.

Kujdestarët e përmendur mund t’u ofrojnë personave me paafësi shërbimet vijuese të cilat plotësojnë nevojat e tyre individuale:

- ndihmë në aktivitetet e jetës së përditshme;
- ndihmë në aktivitetet e kujdesit për shtëpinë;
- shërbime për kujdes shëndetësor;
- shërbime të rehabilitimit;
- shërbime për mbështetje psikosociale;
- pushim shtëpiak dhe shërbime të përkujdesit;

.....

Transportimi dhe adaptimi I automjetit

Shtëpia mund të jetë shumë komode, por jeta nuk përfundon aty!

Është plotësisht e mundur, dhe gjithashtu e dëshirueshme, që ju të formuloni plane dhe të keni dëshirë për ti realizuar ato. Dëshira për të ecur përpara dhe për të jetuar një jetë aktive është pjesë integrale e procesit të reintegrimit social.

Qoftë kjo rikthim në studime ose punë, ose dëshira për të marrë pjesë në aktivitete sportive, pushim (kohë të lire) ose punë vullnetare, ju ju nevojiten mjete për transportim, të adaptuara sipas nevojave të përdoruesve të karrocës.

Gjatë viteve të 70-ta dhe 80-ta janë bërë adaptime të shumta të automjeteve, kështuqë pjesa më e madhe e personave me paaftësi tani mund të blejnë automobil të cilin mund ta vozisin vetë. Për shembull, tani është e mundur të instalohet platformë që ngritet në vagon, për të ulur dyshemenë, ose mbajtjen (pezullimin) automatike dhe aktivizimin e kontollave në lavaman të drejtuara këto përmes përdorimit të sistemit kontrollues të sofistikuar kompjuterik. Madje është e mundur të vozisni përderisa qëndroni I ulur në karrocën tuaj.

Blerja e automjetit

Para se të bleni automjet keni nevojë për leje për vozitje. Informatat për gjetjen e burimeve përkatëse, mund ti gjeni në shoqatën e paraplegjikëve të Kanadës. Rekomandohet që ju të konsultoheni me kompanitë të cilat janë të specializuara për adaptimin e automjeteve për personat me paaftësi. Ata mund t'ju këshillojnë se cili lloj i automjetit është më i përshtatshëm për nevojat e juaja duke pasur në konsideratë kualitetin e prodhimit, zbritjet e ofruara nga prodhuesit, adaptimet në veçanti për çdo automjet, kufizimet funksionale të vozitësit dhe mënyrën e përdorimit.

Mbani mend se jo të gjitha modelet janë të përshtatshme.

Automobili, minibusi dhe autobusi të tre këto janë të adaptuara për paraplegjikët ose tetraplegjikët varësisht nga:

- shkalla e paaftësisë;
- përdorimi i karrocës me dorë (qoftë kjo të paloset ose jo) ose e karrocës elektrike;
- nevojat e familjes.

Shenjat për parkim të rezervuar

Në vitet e 80-ta duke ndjekur kërkesat nga shoqatat që përfaqësojnë peronat me paaftësi, autoritetet qeveritare krijuan dhe regulluan hapësirat për parkim të rezervuar ekskluzivisht për përdoruesit e karrocave.

Hapësirat e këtilla janë qartë të identifikuar. Ato mund të gjenden në lokacione strategjike në rrugë dhe në shumicën e parkingjeve të ndërtesave publike. Ato zakonisht janë të vendosura sa është e mundur më afër hyrjes së këtyre ndërtesave.

Këto etiketa për parkim janë në dispozicion vetëm nëse ju siguron lejen dhe I ngjitni ato në veturën tuaj, përndryshe, kujdes se do të merrni dënim për kundërvajtje!

Adaptimi i transportit publik

Jo çdokush mund të blejë veturë. Për përdoruesit e karrocave, gjatë njëzet viteve të kaluara pothuajse në çdo qytet dhe komunitet të madh janë adaptuar shërbimet e transportit publik.

Shërbimet e këtilla të autobusëve ose taksive (të adaptuar ose jo) ofrojnë transportim “derë në derë” me po të njëjtat çmime si transportimi publik i zakonshëm. Kjo nënkupton se ata vijnë te dera juaj, ju transportojnë atje ku ju dëshironi të shkoni, e pastaj ju kthejnë në shtëpinë tuaj duke u bazuar në orarin e caktuar paraprakisht.

Ky shërbim transporton udhëtarët në punë ose shkollë, spital ose klinikë, dyqan dhe, përfundimisht, në vendet ku zhvillohen aktivitete sportive dhe në vendet e pushimit siç janë restorantet, kinematë, palestrat dhe arena.

Përveç kësaj, disa kompani private të taksive kanë automjete të adoptuara. Shërbimi realizohet përmes rezervimeve, me një pagesë mesatare e cila mund të krahasohet me çmimet e zakonshme të taksive.

Qasja në automjetet adekuate të transportit është esenciale për integrimin social meqenëse personave me paaftësi u jep pavarësi më të madhe për të vazhduar qëllimet e tyre profesionale dhe atyre sociale.

.....

Rrethi juaj

Numri dhe kualiteti i burimeve (pasurive) të rrethit, shpeshherë dikton se ku mund të jetojnë njerëzit. Për të lehtësuar qasjen tuaj në atë që ju rrethon, bëni inventarin e këtyre resurseve, identifikoni dhe përcaktoni ato. Për shembull, është lehtësim nëse dihet vendiku ndodhet banka, qendrat tregtare, klinika mjekësore ose qendra për shërbime komunale lokale, garazha dhe sallonet e ondulimit. Të qenët në gjendje për tu qasur në të gjitha këto shërbime është esenciale për integrimin e çdokujt (dhe jo vetëm personave me paaftësi) në rrethin e tyre.

Në mënyrë ideale, të gjitha këto lokacione duhet të jenë të përshtatshme për përdoruesit e karrocave, por në realitet ky ende nuk është rast, prandaj është e rëndësishme të gjenden institucionet e këtilla të cilat janë të përshtatshme dhe të favorizoni ato me bizneset e juaja. Gjithashtu në beneficionin tuaj është të sensibilizoni institucionet e papërshtatshme dhe nxisni lëvizjen në këtë drejtim.

Aranzhimet mund të bëhen me njerëz siç është shitësin e ushqimeve ose pronarin e depos në qoshe, pastruesin ose me të tjerët të realizojnë dërgime në shtëpi për të shmangur konfrontimet me pengesat e pashmangshme.

“Njohja” e rrethit tuaj do t’ju ndihmojë të shmangni ndjenjat e rastit (rralla) të izolimit dhe pa përkrahjes (paaftësisë) e cila mund të ju shqetësojë. Përpjekjet e juaja për shoqërim do tju ndihmojnë të zbuloni avantazhet e ndihmës së dyanshme dhe gjithashtu do tju ndihmojë të zhvilloni shkathtësi (aftësi) ndërpersonale.

Asociacionet

Qytetin ose zonën të cilën ju keni zgjedhur të jetoni me siguri ka asociacion lokal ose regional për personat me paaftësi. Madje edhe nëse keni humbur dëshirën të këshilloheni ose të jeni pjesë e një grupi të zgjedhur, ju sigurisht mund të përfitoni mjaft nëse i bashkangjiteni ndonjërit prej këtyre grupeve.

Nëse më shumë ju tërheq sporti dhe pushimi ose aktivitetet të cilat përkrahin të drejtat e avokimit (mbrojtjes) për personat me paaftësi, ju padyshim do të përfitoni nga eksperiencia e të tjerëve. Përmes organizatave siç është shoqata e paraplegjikëve të Kanadës, ju shpesh mund të takoni njerëz të cilët kanë qenë në gjendje të integrohen në shoqëri vite më parë, të cilët përçojnë (bartin) një frymë të besimit dhe që janë të përgatitur të ndajnë njohuritë që ato kanë fituar përmes përvojës së tyre.

Ka shumë çka të mësohet nga grupet e personave me paaftësi për zhvillimin dhe përparimin (mbarëvajtjen) e resurseve sociale, të komunitetit dhe ato financiare që u përgjigjet nevojave të tyre të veçanta dhe ndihmon në integrimin e tyre në shoqëri.

Ndjenja se jeni pjesë e grupit, mund ti prijë marrjes së një përgjegjësie më të madhe për jetën tuaj dhe kontribon në pasurimin personal.

Komunikimi

Mjetet e komunikimit që kompensojnë kufizimet funksionale bëhen gjithnjë e më të sofistikura.

Tani telefonët janë hands free, me sekretarësh dhe ritelefonim automatik. Telefonët celularë, vozitësit me paaftësi i japin një ndjenjë të madhe sigurie në rast të dobësimit të shëndetit. Madje ekzistojnë telefona të cilat veprojnë përmes frymës (fryerjes) dhe gjllënjës. Operatori do të kryejë lidhjen me personin e dëshiruar.

Disa shërbime e bëjnë të mundur pagesën e faturave përmes telefonit. Me aparatit për faks ju mund të dërgoni dokumente të shkruara. Madje në ditët e sotme blerja mund të bëhet edhe nga shtëpia, përmes kanaleve të caktuara televizive.

Kompjutorët ndodhen nëshkallë të lartë të progresit teknologjik. Ato sigurojnë qasje në integrimin edukativ dhe gjithashtu bëjnë të mundur të punoni nga larg.

Njerëzit me kufizim të përhershëm të lëvizshmërisë së gjymtyrëve të sipërme të cilët kanë vështirësi në përdorimin e tastaturës së kompjuterit mund të përdorin të adaptuar diçka të tillë. Me sisteme të cilat njohin zërin, përdoruesi flet me mikrofon ndërsa fjalët shënohen në ekran.

Mënyra më e sofistikuar e informimit, interneti, siguron qasje në një numër të jashtëzakonshëm të informatave si dhe u lejon përdoruesve të dërgojnë dhe pranojnë postë elektronike personale ose profesionale.

Mjetet e reja të komunikimit u mundësojnë përdoruesve t'i shmangen udhëtimit dhe të zvogëlojnë ndjenjën e vetmisë dhe izolimit.

.....

Ndihma financiare

Ekzistojnë dy burime të ndihmës financiare të cilat plotësisht ose pjesërisht mbulojnë shpenzimet e sigurimit dhe të mirëmbajtjes së pajisjes dhe ndihmesave teknike:

- financimi publik, përmes programeve të ndryshme qeveritare;
- financimi privat, përmes sigurimit privat dhe fondacioneve private të cilat janë organizata joprofitabile.

Kjo ndihmë financiare jepet vetëm me rekomandim të profesionistit për kujdes shëndetësor.

Financimi publik

Financimi publik është i lidhur me kujdesin shëndetësor publik ose programet e sigurimit në rast aksidenti.

Programet e sigurimit shëndetësor në thelb mbulojnë shpenzimet për pajisjet bazë dhe ndihmave teknike të kërkuara për rehabilitimin shëndetësor dhe atë funksional.

Përveç kësaj, në Kanadë ekzistojnë programe të sigurimit publik për të mbrojtur viktimat nga aksidentet në rrugët kryesore, aksidentet e shkaktuara në vendin e punës dhe viktimat e akteve kriminele. Programet e tilla mbulojnë pjeën më të madhe të shpenzimeve për sigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjeteve ndihmëse të diktura (imponuara) nga gjendja fizike e personave, si dhe shpenzimet që kanë të bëjnë për shembull me ndryshimet në shtëpi ose të automjeteve, me qëllim të arritjes së reintegrimit në shoqëri.

Personi, dëmtimi i të cilit nuk është i mbuluar nga ky program i sigurimit publik dhe i cili nuk ka ndonjë sigurim privat mund të kërkojë nihmë nga programet e tjera investuese për ndihmë financiare. Subvencionet janë në dispozicion për të ndihmuar realizimin e modifikimeve (ndryshimeve) në shtëpi dhe automjeteve ose të ndihmojnë në pagesën e qirasë për njerëzit të cilët kanë të ardhura të ulta.

Financimi privat

Financimi privat zakonisht vjen nga sigurimi personal ose nga fondacionet private. Për të parën, ju duhet të studjoni veçoritë e mbulimit të ofruar në kontratë me kompanitë private të sigurimit. Ndonjëherë mund të jetë e nevojshme që në çështjet zyrtare të sigurohen shërbime nga profesionistë, siç është për shembull juristi (avokati) ose këshilluesi i rehabilitimit.

Fondacionet, u vijnë në ndihmë njerëzve të cilët nuk mbulohen nga asnjë lloj sigurimi goftë nga ai publik ose privat dhe që nuk kanë burime të tjera financiare për të siguruar pajisje ose mjete ndihmëse.

Dyert për ju janë të hapura

“Ruga që personi me dëmtim të palcës kurrizore duhet të ndjekë për rehabilitim dhe riintegrim në shoqëri ndonjëherë mund të jetë e gjatë dhe e mbushur me pengesa. Kjo paraqet një sfidë.

“Ne shpresojmë të kemi pasur sukses në shfrytëzimin e resurseve dhe metodave për momentin e dhënë për të ndihmuar personat me paaftësi të arrijnë pavarësi maksimale sociale dhe fizike për tu rikthyer në jetën aktive të tyre, me kompenzim efektiv për kufizimet funksionale.”

Edhe një herë, libri i Janes u mbyll, ashtu siç edhe u hap... vetvetiu. Dhoma papritmas u erësua. Jane instiktivisht ngriti kokën e saj drejt tavanit, i cili për momentin u përshkua nga rrezet e dritës. Mu në atë çast, një re e përhimtë kaloi mbi ndërtesën ku ndodhej biblioteka. Jashtë fishkëllonte era, shiu binte rëke. Përfundimisht, rrezet e diellit depërtuan përmes pikave të shiut, duke vallëzuar para një gruaje të re. Shikimi i saj u turbullua, ajo nuk mund më të dallonte objektet të cilat e rrethonin atë. Dëgjoi zëra të butë që i përshpëritën. Jane ngadalë hapi sytë, dhe shikoi fytyrat e prindërve të saj, të cilët qëndronin mbi kokë. Nëna e saj me zërin e saj të ëmbël me dashuri i tha: “ke qenë paksa përtace sot vajza ime e vogël”. Jane buzëqeshi: “Nënë, baba, jam mjaft e sigurtë se do të bëhem mirë!”